



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 260, Datë 09.09.2026

MBI

MIRATIMIN E “UDHËRRËFYESIT MBI SHËRBBIMET QË OFROHEN NGA ENTI
RREGULLATOR I ENERGJISË”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 16 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 199, datë 27.11.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.09.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2674 prot., datë 02.09.2026, të përgatitur nga Grupi i Punës për Komunikimet me Publikun “Mbi miratimin e Udhërrëfyesit mbi shërbimet që ofrohen nga Enti Rregullator i Energjisë”,

Konstatoi se:

- Në kuadër të ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe rregullator të sektorit të energjisë, si dhe të nevojës për informimin dhe orientimin e subjekteve të rregulluara, klientëve, investitorëve dhe palëve të tjera të interesuara, është përgatitur versioni i përditësuar i “Udhërrëfyesit mbi shërbimet që ofrohen nga Enti Rregullator i Energjisë”.
- Ligji nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike” ka përcaktuar një kuadër të ri për organizimin dhe funksionimin e sektorit dhe tregut të energjisë elektrike, kompetencat e ERE-s, veprimtaritë e energjisë elektrike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në treg. Kuadri i ri ligjor përfshin, ndër të tjera, depozitimin e energjisë elektrike, agregimin, reagimin ndaj kërkesës, fleksibilitetin, klientët aktivë dhe pikat e rikarikimit.
- Përditësimi i Udhërrëfyesit merr në konsideratë gjithashtu ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe aktet e miratuara në zbatim të tij, përfshirë VKM nr. 368, datë 20.05.2026, si dhe legjislacionin në fuqi për sektorin e gazit natyror dhe procedurat administrative.
- Udhërrëfyesi është konceptuar si një dokument informues dhe orientues, i cili paraqet në mënyrë të përmbledhur funksionet dhe kompetencat kryesore të ERE-s, procedurat që zhvillohen pranë institucionit dhe shërbimet që lidhen me veprimtaritë e rregulluara, pa zëvendësuar dispozitat ligjore, aktet nënligjore dhe aktet rregullatore në fuqi.
- Përmbajtja e Udhërrëfyesit është rishikuar për të reflektuar, ndër të tjera, kompetencat e ERE-s në fushën e licencimit dhe regjistrimit, tarifave, lidhjes dhe aksesit në rrjet, monitorimit, burimeve të rinovueshme, klientëve aktivë, vetëprodhuesve, depozitimit të energjisë elektrike, agregimit, pikave të rikarikimit, mbrojtjes së klientëve dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

- Duke qenë se Udhërrëfyesi ka karakter informues dhe orientues dhe kuadri rregullator në zbatim të ligjit nr. 59/2026 është në zhvillim të vazhdueshëm, dokumenti duhet të përditësohet në funksion të ndryshimeve të legjislacionit dhe akteve rregullatore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë “Udhërrëfyesin mbi shërbimet që ofrohen nga Enti Rregullator i Energjisë”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Udhërrëfyesi, objekt i pikës 1 të këtij vendimi, ka karakter informues dhe orientues dhe shërben për informimin e subjekteve të rregulluara, klientëve, investitorëve dhe palëve të tjera të interesuara mbi kompetencat, shërbimet dhe procedurat që administrohen nga ERE.
3. Udhërrëfyesi nuk krijon të drejta ose detyrime të tjera përtej atyre të përcaktuara në legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi dhe nuk zëvendëson procedurat, kushtet, kriteret apo dokumentacionin e përcaktuar në aktet përkatëse të ERE-s.
4. Në rast mospërputhjeje ndërmjet përmbajtjes së Udhërrëfyesit dhe dispozitave të legjislacionit, akteve nënligjore ose akteve rregullatore në fuqi, zbatohen këto të fundit.
5. Grupi i Punës për Komunikimet me Publikun të marrë masat për publikimin e Udhërrëfyesit në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe në kanalet e tjera zyrtare të komunikimit.
6. Grupi i Punës për Komunikimet me Publikun, të propozojnë përditësimin e Udhërrëfyesit sa herë që ndryshimet e kuadrit ligjor ose rregullator ndikojnë në informacionin e pasqyruar në të.
7. Grupi i Punës për Komunikimet me Publikun të njoftojë për këtë vendim strukturat përkatëse të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 260, datë 09.09.2026

**UDHËRRËFYES MBI SHËRBIMET QË OFROHEN NGA
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
*Version i përditësuar – 2026***

Rreth këtij Udhërrëfyesi

Ky Udhërrëfyesh është hartuar për të orientuar subjektet e rregulluara, investitorët, klientët dhe palët e tjera të interesuara mbi rolin dhe veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë (ERE), shërbimet që ofron, procedurat rregullatore që administrojnë, të drejtat e palëve, si dhe mënyrat e ndërveprimit me institucionin.

Udhërrëfyeshi paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe të strukturuar informacion mbi funksionet dhe kompetencat e ERE-s në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror, rregullat dhe procedurat që ndiqen në ushtrimin e veprimtarisë rregullatore, përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të rregulluara, monitorimin e tregut dhe të veprimtarive të rregulluara, hartimin dhe miratimin e akteve rregullatore, mbrojtjen dhe fuqizimin e klientëve, si dhe bashkëpunimin me institucionet dhe palët e interesuara.

Përditësimi i vitit 2026 reflekton, në veçanti, hyrjen në fuqi të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili ka përcaktuar një kuadër të ri për organizimin dhe funksionimin e sektorit dhe tregut të energjisë elektrike, duke përfshirë ndër të tjera agregimin, reagimin ndaj kërkesës, depozitimin e energjisë elektrike, pikat e rikarikimit, klientët aktivë, fleksibilitetin dhe integrimin e mëtejshëm të tregut shqiptar me tregjet rajonale dhe evropiane.

Udhërrëfyeshi merr në konsideratë gjithashtu ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, aktet nënligjore në fuqi në sektorin e energjisë, si dhe aktet rregullatore, metodologjitë, kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE. Në përmbajtjen e tij merren në konsideratë edhe aktet përkatëse të acquis të Bashkimit Evropian, të përshtatura dhe të zbatueshme në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Informacioni i paraqitur në këtë Udhërrëfyesh ka karakter informues dhe orientues. Ai nuk zëvendëson dhe nuk ndryshon dispozitat e legjislacionit, akteve nënligjore apo akteve rregullatore në fuqi dhe nuk krijon, në vetvete, të drejta, detyrime, kushte ose procedura të ndryshme nga ato të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

Përpara paraqitjes së një aplikimi, kërkesë apo ankese pranë ERE-s, rekomandohet konsultimi i legjislacionit dhe i akteve rregullatore që rregullojnë procedurën përkatëse, pasi kërkesat procedurale, afatet dhe dokumentacioni mund të ndryshojnë në varësi të veprimtarisë, procedurës dhe statusit të subjektit.

Në rast mospërputhjeje ndërmjet informacionit të paraqitur në këtë Udhërrëfyesh dhe dispozitave të legjislacionit, akteve nënligjore ose akteve rregullatore në fuqi, zbatohen këto të fundit.

Referencat kryesore ligjore dhe rregullatore

- Ligji nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”;
- Ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;
- Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- aktet nënligjore në fuqi në sektorin e energjisë;
- aktet rregullatore, metodologjitë, kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE;
- aktet përkatëse të acquis të Bashkimit Evropian, të përshtatura dhe të zbatueshme në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Përmbajtja

1. Koncepte të përgjithshme mbi Entin Rregullator të Energjisë
2. Rregullat dhe procedurat që ndjek ERE
3. Përcaktimi i tarifave dhe çmimeve të rregulluara
4. Monitorimi i tregut dhe i veprimtarive të rregulluara
5. Hartimi dhe miratimi i akteve rregullatore
6. Mbrojtja dhe fuqizimi i klientit
7. Angazhimi me palët e treta dhe institucionet kombëtare e ndërkombëtare

1. KONCEPTE TË PËRGJITHSHME MBI ENTIN RREGULLATOR TË ENERGJISË

1.1 Krijimi dhe pozicioni institucional i ERE-s

Rregullimi i pavarur i sektorit të energjisë në Shqipëri ka filluar në vitin 1995. Kuadri ligjor është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme në funksion të liberalizimit të tregut, ndarjes së veprimtarive të rrjetit nga veprimtaritë konkurruese, mbrojtjes së klientëve, përafrimit me *acquis*-në e Bashkimit Evropian dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Sipas ligjit nr. 59/2006 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ERE është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri dhe drejtohet nga Bordi. ERE është person juridik publik, i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat. Bordi dhe personeli teknik ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente, veprojnë në mënyrë të pavarur nga interesat e tregut dhe marrin vendime autonome, pa ndërhyrje politike.

Pavarësia institucionale e ERE-s ushtrohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë në vendimmarrje. Në ushtrimin e funksioneve të saj, ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike për çështjet që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë, duke ruajtur në çdo rast pavarësinë dhe autonominë e saj rregullatore.

1.2 Misioni dhe objektivat e ERE-s

Misioni i ERE-s nuk kufizohet më vetëm në administrimin e licencave dhe miratimin e tarifave. Në kuadrin e ri ligjor, ERE ka rol qendror në krijimin e kushteve për një treg konkurrues, fleksibël, të sigurt dhe të qëndrueshëm, në garantimin e aksesit transparent e jodiskriminues në rrjet, në mbrojtjen dhe fuqizimin e klientëve, si dhe në integrimin e tregut shqiptar me tregjet rajonale dhe evropiane.

Në ushtrimin e funksioneve të saj, ERE synon të ekuilibrojë interesat e klientëve, operatorëve, investitorëve dhe interesin publik, duke ruajtur parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe eficiencës ekonomike. Ky rol merr rëndësi të veçantë në kushtet e tranzicionit energjetik, rritjes së prodhimit nga burimet e rinovueshme, zhvillimit të depozitimit, digjitalizimit, agregimit dhe pjesëmarrjes aktive të klientëve.

Në kuadër të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, misioni rregullator i ERE-s lidhet edhe me integrimin e energjisë së rinovueshme në treg dhe rrjet, përcaktimin e elementeve rregullatore që lidhen me detyrimin për energjinë e rinovueshme, garantimin e aksesit në rrjet mbi baza transparente e jodiskriminuese dhe administrimin e sistemit të garancive të origjinës. ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe miraton rregullat për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe revokimin/anulimin e tyre.

1.3 Fusha e rregullimit

Ligji nr. 59/2006, rregullon marrëdhëniet në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, por, ndryshe nga kuadri i mëparshëm, përfshin shprehimisht edhe agregimin, reagimin ndaj kërkesës, funksionimin e tregut, depozitimin e energjisë elektrike dhe funksionimin e pikave të rikarikimit. Për këtë arsye, edhe shërbimet dhe mbikëqyrja rregullatore e ERE-s duhet të lexohen në këtë kuadër më të gjerë.

- prodhimin e energjisë elektrike dhe kushtet e ushtrimit të veprimtarisë;
- transmetimin, shpërndarjen dhe funksionimin e rrjeteve;
- furnizimin, tregtimin dhe funksionimin e tregut të organizuar;
- depozitimin e energjisë elektrike, sipas regjimit të licencimit ose regjistrimit që përcakton ligji;

- agregimin dhe pjesëmarrjen e agregatorëve, përfshirë agregatorët e pavarur;
- reagimin ndaj kërkesës dhe mekanizmat e fleksibilitetit;
- aksesin dhe lidhjen në rrjet, përfshirë trajtimin jodiskriminues të përdoruesve të rinj të sistemit;
- pikat e rikarikimit të automjeteve elektrike, në masën dhe mënyrën që parashikon kuadri ligjor;
- mbrojtjen e klientëve, klientët aktivë dhe pjesëmarrjen e tyre në treg;
- burimet e rinovueshme, vetëprodhimin, komunitetet e energjisë së rinovueshme dhe garancitë e origjinës;
- tarifat, metodologjitë, kodet, rregullat e tregut dhe standardet e cilësisë së shërbimit;
- monitorimin e tregut, konkurrencës, performancës së operatorëve dhe zbatimit të detyrimeve ligjore e rregullatore.

1.4 Kompetencat dhe shërbimet kryesore

Licencimi, regjistrimi dhe autorizimet rregullatore

ERE administron procedurat e licencimit për veprimtaritë për të cilat ligji kërkon licencë, si dhe procedurat e modifikimit, transferimit, rinovimit dhe heqjes së licencave. Në kuadrin e ligjit nr. 59/2026, dokumentacioni dhe procedurat duhet të interpretohen sipas kategorive të reja të aktivitetit të energjisë elektrike dhe dispozitave tranzitore.

Depozitimi i energjisë elektrike

Depozitimi i energjisë elektrike përbën një nga veprimtaritë e parashikuara nga ligji nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Kuadri ligjor përcakton dispozita të posaçme për zhvillimin dhe operimin e impianteve të depozitimit, si dhe parashikon, sipas rastit, procedura që lidhen me licencimin dhe regjistrimin e tyre.

Në mënyrë të veçantë, për impiantet e depozitimit që ndodhen në zhvillim ose operim në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026, ligji parashikon dispozita tranzitore që lidhen me regjistrimin e tyre pranë ERE-s. Regjistrimi synon evidentimin dhe administrimin e informacionit mbi impiantet e depozitimit që përfshihen në fushën e zbatimit të këtyre dispozitave, si dhe përcaktimin e statusit të tyre në raport me kërkesat e kuadrit të ri ligjor.

ERE administron procesin e regjistrimit në përputhje me përcaktimet dhe afatet e ligjit, mbi bazën e të dhënave dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjektet. Regjistrimi dhe licencimi përbëjnë procedura të dallueshme dhe trajtimi i secilit rast përcaktohet në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme, karakteristikat e impiantit dhe statusin e veprimtarisë përkatëse.

Depozitimi i lidhur me impiantet prodhuese

Ligji nr. 59/2026 përmban dispozita të posaçme edhe për depozitimin e energjisë elektrike të lidhur me veprimtarinë e prodhimit. Trajtimi rregullator i këtyre rasteve vlerësohet në funksion të konfigurimit konkret të projektit, marrëdhënies së impiantit të depozitimit me impiantin prodhues, statusit të veprimtarisë ekzistuese, si dhe dokumentacionit teknik dhe juridik përkatës.

Në këtë kuadër, ERE shqyrton kërkesat dhe njoftimet e paraqitura nga subjektet dhe vlerëson, sipas rastit, zbatimin e dispozitave që lidhen me regjistrimin, licencimin apo procedurat e tjera rregullatore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ky vlerësim kryhet pa cenuar kompetencat e institucioneve të tjera përgjegjëse për autorizimet apo miratimet që kërkohen sipas legjislacionit përkatës.

Agregimi, reagimi ndaj kërkesës dhe fleksibiliteti

Agregimi është një element i ri thelbësor i arkitekturës së tregut. ERE ka përgjegjësi të sigurojë që kuadri rregullator të lejojë pjesëmarrjen e agregatorëve, përfshirë agregatorët e pavarur, në tregjet e energjisë elektrike në kushte transparente dhe jodiskriminuese. Rregullat duhet të përcaktojnë

rolet dhe përgjegjësitë, shkëmbimin e të dhënave, përgjegjësinë për disbalancat dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

ERE përcakton, në bashkëpunim me pjesëmarrësit e tregut dhe klientët fundorë, kërkesat teknike për pjesëmarrjen e reagimit ndaj kërkesës në tregjet e energjisë elektrike, përfshirë pjesëmarrjen përmes ngarkesave të agreguara. Në këtë mënyrë, klienti nuk shihet vetëm si marrës pasiv i energjisë, por mund të ofrojë fleksibilitet dhe të marrë pjesë në mekanizma tregu sipas kushteve të ligjit.

Pikat e rikarikimit të automjeteve elektrike

Ligji nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike” ka përfshirë në mënyrë të shprehur funksionimin e pikave të rikarikimit në fushën e veprimit të tij. Në këtë drejtim, neni 2 i ligjit parashikon se marrëdhëniet që lidhen me funksionimin e pikave të rikarikimit janë pjesë e veprimtarive të rregulluara nga ky ligj, ndërsa neni 3, pika 5, në përkufizimin e “aktivitetit të energjisë elektrike”, përfshin edhe operimin e pikave të rikarikimit.

Në kuadër të funksioneve të saj rregullatore, ERE ushtron kompetencat që ligji i njeh edhe në lidhje me këtë veprimtari. Në veçanti, neni 24, shkronja “k”, parashikon monitorimin nga ERE të kushteve dhe tarifave të lidhjes së prodhuesve të rinj të energjisë elektrike, impianteve të depozitimit të energjisë dhe pikave të rikarikimit.

Ligji përmban gjithashtu dispozita që e lidhin operimin e pikave të rikarikimit me regjimin rregullator të administruar nga ERE. Në këtë drejtim, neni 45, pika 7, në kuadër të rregullimit të heqjes së licencës, i referohet edhe licencës për operimin e pikës së rikarikimit, ndërsa neni 46, pika 2, përfshin operimin e pikave të rikarikimit ndër veprimtaritë për të cilat rregullohet transferimi i aseteve të përdorura për ushtrimin e aktivitetit përkatës.

Trajtimi rregullator i operimit të pikave të rikarikimit dhe përcaktimi i kërkesave për ushtrimin e kësaj veprimtarie bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 59/2026 dhe aktet rregullatore të miratuara në zbatim të tij, duke marrë në konsideratë natyrën dhe karakteristikat e veprimtarisë, kushtet e lidhjes në rrjet, si dhe parimet e transparencës, konkurrencës dhe trajtimit jodiskriminues.

Burimet e rinovueshme dhe komunitetet e energjisë

Në kuadër të nxitjes së përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, ERE ushtron funksionet dhe kompetencat që i përcaktohen nga ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, në ndërveprim me kompetencat që ushtron sipas ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Veprimtaria rregullatore e ERE-së në këtë fushë synon të kontribuojë në integrimin e energjisë nga burimet e rinovueshme në sistemin dhe tregun e energjisë elektrike, garantimin e aksesit transparent dhe jodiskriminues në rrjet, krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e vetëprodhuesve në treg, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të klientëve.

Në zbatim të kuadrit ligjor për burimet e rinovueshme dhe të VKM-së nr. 368, datë 20.5.2026, ERE ushtron kompetenca të posaçme edhe në lidhje me vetëprodhuesit e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe skemën e kompensimit të bazuar në faturimin neto. Në këtë kuadër, ERE miraton dhe mbikëqyr kuadrin rregullator për lidhjen në sistemin e shpërndarjes, shqyrton ankesat që lidhen me refuzimin e aplikimeve për lidhje, si dhe miraton ndryshimet e nevojshme në rregulloren e lidhjeve të reja, Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes, sipas procedurave të përcaktuara në legjisllacionin në fuqi.

ERE ushtron gjithashtu kompetenca në funksionimin e skemës së faturimit neto, duke miratuar modelin tip të marrëveshjes ndërmjet Furnizuesit të Shërbimit Universal/Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe vetëprodhuesve që përfitojnë nga kjo skemë, si dhe kushtet e përgjithshme të

marrëveshjes tip për vetëprodhuesit dhe furnizuesit e licencuar në tregun e lirë. Në përputhje me metodologjinë dhe kriteret e përcaktuara nga kuadri në fuqi, ERE miraton edhe çmimin e blerjes së energjisë elektrike të injektuar në rrjet nga vetëprodhuesit që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal/Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Nëpërmjet këtyre funksioneve, si dhe kompetencave të tjera që i ngarkohen nga legjislacioni për burimet e rinovueshme, përfshirë ato që lidhen me garancitë e origjinës, ERE kontribuon në krijimin e një kuadri rregullator transparent dhe jodiskriminues për zhvillimin e energjisë së rinovueshme, vetëprodhimit dhe vetëkonsumit, integrimin e tyre në tregun e energjisë elektrike dhe realizimin e tranzicionit energjetik.

Klientët aktivë

Ligji nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike” i jep klientit fundor një rol më aktiv në tregun e energjisë elektrike, duke i mundësuar që, kur plotëson kushtet e parashikuara nga ligji, krahas konsumit të energjisë të prodhojë, depozitojë ose shesë energjinë e vetëprodhuar, si dhe të marrë pjesë në agregim, reagimin ndaj kërkesës dhe skemat e fleksibilitetit. Sipas nenit 96, pika 1, klientët fundorë kanë të drejtë të veprojnë si klientë aktivë pa iu nënshtruar kërkesave teknike dhe administrative, procedurave apo tarifave që janë disproporcionale ose diskriminuese.

Në raport me klientët aktivë, ERE ushtron funksionet e saj rregullatore dhe mbikëqyrëse në ato çështje që lidhen me tregun e energjisë elektrike, përdorimin e rrjetit, tarifat, agregimin, balancimin dhe marrëdhëniet e klientit me subjektet e licencuara. Nëpërmjet miratimit të rregullave dhe metodologjive që janë në kompetencën e saj, si dhe monitorimit të operatorëve dhe pjesëmarrësve të tregut, ERE kujdeset që pjesëmarrja e klientëve aktivë të realizohet në kushte transparente dhe jodiskriminuese dhe pa krijuar pengesa të pajustificuara për ushtrimin e të drejtave që u njeh ligji. Një nga fushat ku ndërhyrja rregullatore e ERE-s është e rëndësishme lidhet me aksesin dhe përdorimin e rrjetit. Klienti aktiv mund të konsumojë energji nga rrjeti dhe, sipas konfigurimit të tij, të injektojë energji në të. Për këtë arsye, ERE, në ushtrimin e kompetencave të saj për miratimin e tarifave dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemit, siguron që tarifat e rrjetit dhe kushtet përkatëse të zbatohen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Në këtë drejtim, neni 96, pika 3, shkronja “dh”, parashikon që klientët aktivë u nënshtrohen tarifave të rrjetit që pasqyrojnë kostot, janë transparente dhe jodiskriminuese dhe llogariten veçmas për energjinë elektrike të injektuar në rrjet dhe atë të konsumuar nga rrjeti.

ERE ka rol rregullator edhe në mundësimin e pjesëmarrjes së klientit aktiv në treg nëpërmjet agregimit dhe reagimit ndaj kërkesës. Në përputhje me nenin 96, pika 3, klienti aktiv mund të veprojë drejtpërdrejt ose nëpërmjet agregimit, të shesë energjinë elektrike të vetëprodhuar dhe të ofrojë shërbime të reagimit ndaj kërkesës dhe fleksibilitetit. Në këtë fushë, ERE ushtron kompetencat që ligji i njeh për rregullimin dhe monitorimin e tregut, agregimit dhe marrëdhënieve ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, me qëllim që pjesëmarrja e klientëve aktivë të mos pengohet nga kushte diskriminuese ose të pajustificuara.

1.5 Organizimi, Bordi dhe financimi

ERE drejtohet nga Bordi, i përbërë nga Kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari dhe anëtarët zgjidhen nga Kuvendi për mandat pesëvjeçar, me të drejtë rinovimi vetëm një herë, sipas kriterëve dhe procedurës së parashikuar në ligjin nr. 59/2026.

Vendimmarrja e Bordit realizohet sipas ligjit dhe rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s. Vendimet e ERE-së arsyetohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe bëhen publike për të garantuar transparencën e veprimtarisë dhe vendimmarrjes rregullatore. Ato publikohen në faqen zyrtare të internetit të ERE-së, ndërsa në Fletoren Zyrtare

publikohen vendimet për të cilat legjislacioni në fuqi parashikon shprehimisht detyrimin e botimit. Palët mund të kërkojnë rishikimin e vendimit brenda 7 ditëve kalendarike në kushtet e parashikuara nga ligji. Vendimet e Bordit ankimohen në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga publikimi në Fletoren Zyrtare; ankimi nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe.

Buxheti i ERE-s miratohet nga Bordi dhe ERE ka autonomi në përdorimin e tij. Burimet financiare përbëhen nga tarifat rregullatore, tarifat e licencës dhe tarifa të tjera të parashikuara nga legjislacioni sektorial. Veprimtaria financiare e ERE-së auditohet nga një ekspert i zgjedhur nga ERE-ja nga regjistri publik i ekspertëve kontabël të miratuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. RREGULLAT DHE PROCEDURAT QË NDJEK ERE

2.1 Kuadri procedural

Procedurat administrative në ERE zhvillohen në përputhje me ligjin nr. 59/2026, ligjin nr. 102/2015 për sektorin e gazit natyror, ligjin nr. 24/2023 për burimet e rinovueshme, Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin për organet kolegjiale, të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet rregullatore të ERE-s.

Në çdo procedurë, ERE administron dokumentacionin, verifikon kompetencën dhe legjitimitimin e palëve, kërkon plotësime kur është e nevojshme, garanton të drejtën për t'u dëgjuar dhe merr vendim të arsyetuar mbi bazën e fakteve, provave dhe kuadrit juridik të zbatueshëm.

2.2 Si fillon një procedurë në ERE?

Një procedurë mund të fillojë me kërkesë të një subjekti, ne kuader të një ankese të klientit, me kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshjeje, me aplikim për licencë ose modifikim licence, me kërkesë që lidhet me tarifa, plane zhvillimi, certifikime, garanci origjine apo çështje të tjera në kompetencë të ERE-s. Në rastet e parashikuara nga ligji, ERE mund të veprojë edhe me iniciativë.

Për aktivitetet e reja të njohura nga ligji nr. 59/2026, përfshirë depozitimin, agregimin dhe reagimin ndaj kërkesës, procedura konkrete përcaktohet nga dispozita ligjore përkatëse dhe nga aktet rregullatore të ERE-s.

2.3 Seancat dëgjimore dhe pjesëmarrja e palëve

ERE mund të organizojë seanca dëgjimore teknike dhe publike. Seancat shërbejnë për sqarimin e fakteve, diskutimin e çështjeve teknike dhe ekonomike, marrjen e komenteve të palëve dhe rritjen e transparencës së vendimmarrjes. Organizimi i tyre bëhet sipas ligjit dhe rregullave procedurale të ERE-s.

2.4 Mbledhjet dhe vendimmarrja e Bordit

Bordi shqyrton çështjet që, sipas ligjit dhe akteve rregullatore, kërkojnë vendimmarrje kolegjiale. Në këtë kategori përfshihen licencat dhe ndryshimet e tyre, tarifat dhe metodologjitë, certifikimet, kodet dhe rregullat, aktet normative rregullatore, garancitë e origjinës kur kërkohet vendimmarrje e Bordit, masat administrative dhe çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

2.5 Procedura e licencimit

Aplikuesi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin sipas ligjit dhe rregullores së licencimit. ERE shqyrton plotësinë formale dhe përmbajtjen teknike, juridike dhe financiare të aplikimit. Fillimi i procedurës nuk paragjykon vendimin përfundimtar dhe nuk zëvendëson detyrimin e aplikuesit për të plotësuar kushtet materiale të licencimit.

Kur vendimmarrja varet nga një çështje paraprake që është në kompetencën e një organi tjetër, ERE vepron në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Kërkimi i një sqarimi apo akti

nga një autoritet tjetër duhet të lidhet me një element që ka ndikim real në ligjshmërinë e vendimmarrjes dhe nuk duhet të përdoret për të transferuar përgjegjësinë rregullatore.

2.6 Regjistrimi i impianteve të depozitimit

Për rastet që ligji nr. 59/2026 i nënshtrohen regjistrimit, ERE administron të dhënat identifikuese, teknike dhe juridike të impiantit dhe operatorit. Qëllimi i regjistrimit është krijimi i një pasqyre të saktë të kapaciteteve të depozitimit dhe rregullimi i statusit të subjekteve sipas dispozitave tranzitore. Regjistrimi nuk krijon vetvetiu të drejtat që ligji i lidh me pajisjen me licencë, por, gjatë periudhës kalimtare të parashikuar nga ligji nr. 59/2026, përbën një parakusht për evidentimin dhe vijimin e procedurave përkatëse nga subjektet që ushtrojnë ose zhvillojnë veprimtarinë e depozitimit të energjisë elektrike dhe që përfshihen në regjimin kalimtar të përcaktuar nga ligji. Përmbushja e detyrimit për regjistrim nuk zëvendëson detyrimin për pajisjen me licencë, në rastet kur kjo e fundit kërkohet nga ligji.

2.7 Akses i informacion

ERE zhvillon veprimtarinë mbi parimin e transparencës. Informacioni për vendimet, konsultimet, tarifat, të dhënat e tregut dhe aktet rregullatore publikohet në faqen zyrtare, me respektimin e kufizimeve ligjore për sekretin tregtar, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

3. PËRCAKTIMI I TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË RREGULLUARA

ERE miraton tarifat dhe metodologjitë për aktivitetet e rregulluara në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, eficiencës ekonomike dhe rikuperimit të kostove të arsyeshme. Tarifat e rrjetit duhet të krijojnë sinjale të përshtatshme për përdorimin efikas të sistemit, investimet, integrimin e burimeve të rinovueshme, depozitimit dhe fleksibilitetit, pa krijuar diskriminim ndërmjet kategorive të përdoruesve.

Në shqyrtimin e aplikimeve tarifore, ERE analizon të ardhurat e kërkuara, kostot operative, investimet, amortizimin, humbjet, cilësinë e shërbimit dhe elemente të tjera të përcaktuara nga metodologjitë përkatëse. Realizimi i investimeve dhe treguesit e performancës mund të ndikojnë në vlerësimin rregullator dhe në korrigjimet përkatëse.

Në kuadër të ligjit nr. 24/2023, ERE miraton metodologjinë për detyrimin e energjisë së rinovueshme dhe përcakton këtë detyrim sipas kërkesave ligjore. Për komunitetet e energjisë së rinovueshme dhe vetëprodhuesit, ERE ushtron kompetencat e saj rregullatore në lidhje me përcaktimin dhe miratimin e tarifave dhe metodologjive përkatëse, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. MONITORIMI I TREGUT DHE I VEPRIMTARIVE TË RREGULLUARA

Monitorimi është një nga funksionet qendrore të ERE-s. Kuadri i ri e zhvendos fokusin nga kontrolli formal i kushteve të licencës drejt një mbikëqyrjeje më të gjerë të funksionimit të tregut, konkurrencës, performancës së rrjeteve, cilësisë së furnizimit, balancimit, fleksibilitetit, të drejtave të klientëve dhe integritetit të burimeve të reja.

- funksionimin dhe konkurrencën në tregun me shumicë dhe pakicë;
- çmimet, ofertat, sjelljen e pjesëmarrësve dhe transparencën e tregut;
- performancën e OST-së dhe OSSH-së, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e rrjetit;
- zbatimin e kodeve, rregullave të tregut, rregullave të balancimit dhe kushteve të aksesit;
- realizimin e planeve të investimeve dhe zhvillimit të rrjetit;
- pjesëmarrjen e agregatorëve, reagimin ndaj kërkesës dhe zhvillimin e fleksibilitetit;
- integrimin dhe operimin e depozitimit të energjisë;
- respektimin e të drejtave të klientëve, përfshirë klientët aktivë;

- zbatimin e detyrimeve nga furnizuesit dhe operatorët;
- treguesit e cilësisë së shërbimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit.

ERE publikon të dhëna periodike për funksionimin e tregut sipas kërkesave të ligjit nr. 59/2026. Monitorimi mbështetet në raportime, të dhëna të tregut, informacione nga operatorët, kontrolle dhe inspektime, si dhe në analiza të kryera nga strukturat e ERE-s.

Kur konstatohen shkelje, ERE mund të kërkojë masa korrigjuese dhe, kur plotësohen kushtet ligjore, të zbatojë masat administrative të parashikuara nga ligji. Çdo masë duhet të jetë e arsyetuar dhe proporcionale me natyrën dhe rëndësinë e shkeljes.

5. HARTIMI DHE MIRATIMI I AKTEVE RREGULLATORE

ERE miraton rregullore, metodologji, kode, rregulla, kontrata tip dhe akte të tjera rregullatore brenda kompetencave që i jep ligji. Kuadri i ri kërkon rishikimin e akteve ekzistuese dhe hartimin e akteve të reja për të reflektuar depozitimin, agregimin, reagimin ndaj kërkesës, fleksibilitetin, të drejtat e klientëve, integritetin e tregut dhe kërkesat e acquis të zbatueshme në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

Projektaktet që i nënshtrohen konsultimit publik publikohen dhe u jepet palëve të interesuara mundësia të paraqesin komente. Struktura përgjegjëse shqyrton komentet dhe rekomandimet dhe arsyeton pranimin ose mospranimin e tyre. Afatet dhe mënyra e konsultimit përcaktohen nga legjislacioni në fuqi dhe rregullat e ERE-s. Aktet që lidhen me çështje individuale ose me procedura konkrete administrative shqyrtohen dhe miratohen sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara nga legjislacioni sektorial dhe administrativ. Në çdo rast, vendimmarrja e ERE-s mbështetet në parimet e ligjshmërisë, transparencës, paanshmërisë, proporcionalitetit dhe arsyetimit të vendimit.

6. MBROJTJA DHE FUQIZIMI I KLIENTIT

Mbrojtja e klientit është një objektiv themelor i rregullimit. Ligji nr. 59/2026 e zgjeron këtë koncept duke e lidhur jo vetëm me vazhdimësinë dhe cilësinë e furnizimit, por edhe me transparencën e kontratave dhe faturimit, të drejtën për të ndryshuar furnizues, aksesin në të dhënat e konsumit, kontratat me çmime dinamike, agregimin dhe pjesëmarrjen aktive në treg.

6.1 Informimi dhe faturimi

ERE siguron që faturat dhe informacioni i faturimit të jenë të sakta, të qarta, koncize dhe të kuptueshme. Klientët fundorë kanë të drejtë të marrin faturat dhe informacionin e faturimit pa pagesë dhe, sipas kërkesës, të marrin shpjegim të qartë për mënyrën e përlllogaritjes së faturës.

6.2 Platforma e krahasimit të ofertave

Një nga shërbimet e reja me rëndësi të drejtpërdrejtë për klientët është platforma online për krahasimin e ofertave. Ligji nr. 59/2026 parashikon që ERE të sigurojë akses pa pagesë në një mjet të pavarur krahasimi, të operuar nga ERE, i cili mbulon tregun dhe mundëson krahasimin e ofertave të furnizuesve, përfshirë ofertat me çmime dinamike, mbi bazën e kriterëve të qarta dhe objektive.

Në zbatim të këtyre kërkesave, platforma e krahasimit funksionon në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tregut, siguron trajtim të barabartë të furnizuesve, paraqet informacionin në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, ofron të dhëna të sakta dhe të përditësuara dhe të aksesueshme edhe për personat me aftësi të kufizuara. Nëpërmjet kësaj platforme, ERE u mundëson klientëve krahasimin e ofertave të disponueshme në treg dhe marrjen e vendimeve më të informuara për zgjedhjen e furnizuesit dhe ofertës së energjisë elektrike.

6.3 Klienti aktiv, vetëprodhimi dhe fleksibiliteti

Klientët aktivë përbëjnë një kategori të re të pjesëmarrjes aktive të klientëve në tregun e energjisë elektrike. Në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, klienti aktiv është klienti fundor ose një grup klientësh fundorë që veprojnë së bashku, i cili konsumon ose depoziton energjinë elektrike të prodhuar brenda ambienteve të tij, shet energjinë elektrike të vetëprodhuar ose merr pjesë në skemat e fleksibilitetit ose të eficiencës së energjisë, me kusht që këto veprimtari të mos përbëjnë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale.

Të drejtat dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së klientëve aktivë rregullohen në mënyrë të posaçme nga neni 96 i ligjit nr. 59/2026. Në këtë kuadër, klientëve aktivë u njihet mundësia për të vepruar drejtpërdrejt ose nëpërmjet agregimit, për të shitur energjinë elektrike të vetëprodhuar, për të marrë pjesë në skemat e fleksibilitetit dhe të eficiencës së energjisë dhe për të përdorur sistemet e depozitimit të energjisë, sipas kushteve të përcaktuara nga ligji.

Në zbatim të nenit 96 dhe të dispozitave të tjera të ligjit që rregullojnë aksesin në rrjet, agregimin, reagimin ndaj kërkesës, fleksibilitetin, matjen dhe funksionimin e tregut, ERE ushtron funksionet e saj rregullatore dhe mbikëqyrëse për të garantuar që pjesëmarrja e klientëve aktivë të realizohet në kushte transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese. Në këtë funksion përfshihet miratimi dhe mbikëqyrja, sipas kompetencave ligjore të ERE-së, e rregullave dhe metodologjive që lidhen me aksesin dhe përdorimin e rrjetit, tarifat e rrjetit, matjen dhe administrimin e të dhënave, marrëdhëniet me furnizuesit dhe operatorët e sistemit, si dhe pjesëmarrjen e klientëve aktivë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet agregimit, në mekanizmat e fleksibilitetit dhe reagimit ndaj kërkesës. Në ushtrimin e këtyre kompetencave, ERE mbikëqyr respektimin e të drejtave të klientëve aktivë dhe zbatimin e detyrimeve përkatëse, duke synuar që statusi i klientit aktiv të mos shoqërohet me procedura, tarifa ose kushte të pajustifikuara apo diskriminuese, pa cënuar detyrimet që lidhen me përdorimin e rrjetit, matjen, balancimin dhe funksionimin e sigurt të sistemit.

6.4 Agregimi dhe mbrojtja e klientit

Agregimi, sipas nenit 3 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, është funksioni nëpërmjet të cilit një person fizik ose juridik kombinon ngarkesat e disa konsumatorëve ose energjinë elektrike të prodhuar, për shitje, blerje ose ankand në tregun e energjisë elektrike. Agreguesi është pjesëmarrësi i tregut që ushtron këtë veprimtari.

Sipas nenit 99 të ligjit nr. 59/2026, klientët kanë të drejtë të blejnë dhe të shesin shërbime të energjisë elektrike, përfshirë agregimin, në mënyrë të pavarur nga kontrata e furnizimit dhe nga një shoqëri elektroenergjetike sipas zgjedhjes së tyre. Përpara lidhjes së kontratës, agreguesi duhet të informojë klientin për termat dhe kushtet kontraktuale të shërbimeve të ofruara dhe, me kërkesë të klientit, t'i vendosë atij në dispozicion, pa pagesë, të dhënat përkatëse të përgjigjes ndaj kërkesës ose të energjisë së furnizuar dhe të shitur.

Në këtë kuadër, neni 99 i ligjit nr. 59/2026 i ngarkon ERE-së përgatitjen dhe publikimin e rregulloreve të detajuara për agregimin, marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së agregimit dhe zbatimin e kontratave të agregimit. ERE ushtron gjithashtu funksionet e saj rregullatore dhe mbikëqyrëse për të garantuar që të drejtat e klientëve që marrin pjesë në agregim të ushtrohen në mënyrë jodiskriminuese dhe që këta klientë të mos u nënshtrohen tarifave, kërkesave apo procedurave teknike dhe administrative diskriminuese nga operatori i rrjetit apo furnizuesi, për shkak të lidhjes së një kontrate agregimi.

Roli i ERE-së në këtë fushë lidhet edhe me nenin 96 të ligjit, i cili u njeh klientëve aktivë të drejtën për të operuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet agregimit dhe për të ofruar shërbime të përgjigjes ndaj kërkesës e për të marrë pjesë në skemat e fleksibilitetit dhe të eficiencës së energjisë.

6.5 Ankesat dhe mosmarrëveshjet

ERE trajton ankesat e klientëve dhe zgjidh mosmarrëveshjet që legjislacioni në fuqi ia njeh në kompetencë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj dhe në aktet rregullatore të miratuara prej saj. Ky funksion përfshin, ndër të tjera, shqyrtimin e çështjeve që lidhen me respektimin e të drejtave të klientëve, përmbushjen e detyrimeve nga të licencuarit, cilësinë e shërbimit, zbatimin e kushteve kontraktuale dhe rregullatore, si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve për çështjet që lidhen me veprimtaritë e rregulluara. Nëpërmjet trajtimit të ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ERE garanton një proces transparent, të paanshëm dhe jodiskriminues dhe ushtron njëkohësisht funksionin e saj për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të klientëve. Zhvillimi i tregut sjell edhe kategori të reja mosmarrëveshjesh, përfshirë ato që mund të lindin nga agregimi, përgjegjësia për disbalancat, aksesit në të dhëna dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të rinj të tregut.

7. ANGAZHIMI ME PALËT E TRETA DHE INSTITUCIONET KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE

ERE bashkëpunon me Kuvendin, ministrinë përgjegjëse për energjinë, autoritetet publike, operatorët e sistemit, pjesëmarrësit e tregut, organizatat e konsumatorëve dhe palët e tjera të interesuara, duke respektuar ndarjen e kompetencave dhe pavarësinë rregullatore.

Në dimensionin ndërkombëtar, ERE bashkëpunon me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, ECRB, ACER dhe organizata të tjera rregullatore, sipas kuadrit juridik të zbatueshëm. Integrimi i tregut shqiptar kërkon koordinim në çështje të kapaciteteve ndërkufitare, kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit, tregjeve të organizuara, balancimit, sigurisë së furnizimit dhe zhvillimit rajonal.

Në ushtrimin e këtij bashkëpunimi, ERE ruan kompetencën e vet vendimmarrëse dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga ligji shqiptar dhe nga angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të Komunitetit të Energjisë.